



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

Numri i lëndës: 2020:026387

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06213747

**Ac.nr.1313/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit L.R., nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.M., avokat në Gjilan, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqësojnë L.L. dhe B.M., zyrtar ligjor tek e paditura, me objekt të kontestit pagesa e shpërblimit jubilar, shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.408/20, të datës 17.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 26.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.408/20, i datës 17.11.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktgjykimin e atakuar C.nr.408/20, të datës 17.11.2021, ka vendosur si në vijim: “I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit L.R., nga Gjilani dhe **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan që paditësit t’ia paguajë shumën totale 1,542,10 € dhe atë: - në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite punë tek e paditura 50% të pagës së tij bazë, nënkupton shumën prej 210,50 €; - në emër të kompensimit për shpenzimet e shujtës gjatë punës për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datë 16.04.2021, për 622 ditë pune të kaluara në punë tek e paditura nga 2 € në ditë, nënkupton shumën prej 1.244 €; - dhe në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit 70% të çmimit të biletës së autobusit për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datë 16.04.2021, pra për 268 ditë punë nga 0,70 € në ditë shuma prej 187,60 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë 21.02.2020 deri në pagesën përfundimtare, brenda 7 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit; II. **OBLIGOHET** e paditura që në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit t’ia kompensojë paditësit shpenzimet e procedurës në shumën prej 270,20 €”.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura, përmes përfaqësuesve të autorizuar, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me

propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovoj në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar C.nr.408/20, të datës 17.11.2021, ta prishë si të pabazuar në legjislacionin e Kosovës dhe ta kthej rastin në rigjykim dhe rivendosje ose ta refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Paditësi ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar C.nr.408/2020, të datës 17.11.2021, ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, kundër të paditurës ka parashtruar padi me datën 21.02.2020, për kompensimin e shpërblimit jubilar, shujtave dhe shpenzimeve të udhëtimit, të cilën e ka precizuar me parashtresën e datës 03.11.2021 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.11.2021, duke kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të aprovohet në tërësi, ashtu që të detyrohet e paditura që paditësit për periudhat si në kërkesëpadi, t'ia paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, me kamatë ligjore, si dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore. E paditura, me anë të përgjigjes në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit duke propozuar që e njëjtja të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.408/20, të datës 17.11.2021, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se përmes provave të administruara është vërtetuar që paditësi është i punësuar tek e paditura me pagën bazë 421 €, i njëjti sipas vërtetimit të lëshuar nga Sh.F.M.U. “Vatra e Diturisë” ka 10 vite përvojë pune, udhëton në linjën Gjilan – Livoç i Epërm me çmim të biletës 1.00 € vajtje – ardhje, si dhe është vërtetuar që gjatë periudhës 18.04.2017 deri me 16.04.2021 ka 622 ditë të prezencës në punë. Gjykata ka theksuar se nuk ishte kontestuese që e paditura nuk ka bërë kompensimin e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit e udhëtimit në punë, andaj duke iu referuar nenit 35 par. 5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit, të vitit 2017, paditësit ia ka njohur kompensimin e pagës jubilarë, shpenzimeve të udhëtimit dhe udhëtimit në shumat si në dispozitivin e aktgjykimi të atakuar. Ndërsa pretendimet e të paditurës se paditësi nuk i ka rritur 10 vite përvojë pune, nuk janë dëshmuar shpenzimet e udhëtimit dhe paditësi nuk ka shtjerrë mjetet e brendshme, gjykata i vlerësoi si të pa bazuara pasi që të njëjtat në të kundërt janë vërtetuar përmes provave të administruara. Vendimi për kamatën ligjore gjykata e ka mbështetur në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka arsyetuar konform nenit 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-

së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) i LPK-së për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivin e aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme për shumat e aprovuara në emër të pagës jubilarë për 10 vite përvojë pune, kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e prezencës në punë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit janë të pabazuara edhe pretendimet e të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që përmes kontratës së punës dhe vërtetimit të lëshuar nga Shkolla Filllore “Vatra e Diturisë”, në Livoç të Epërm, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, është vërtetuar se paditësi është në marrëdhënie pune të e paditura dhe ka përvojë pune në mësimdhënie 10 vite, si dhe udhëton nga Gjilani në Livoç të Epërm dhe anasjelltas. Sa i përket pagës, të njëjtën gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka vërtetuar përmes listës së pagës të nxjerrë nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Ndërsa, përmes vërtetimit të lëshuar nga Shkolla Filllore “Vatra e Diturisë”, në Livoç të Epërm, është vërtetuar se paditësi për periudhën kohore 18.04.2017 deri me 16.04.2021 ka realizuar 268 ditë të pranisë në punë, si dhe përmes vërtetimit të lëshuar nga Sh.F.M.U “Nazmi Hoxha”, në Gjilan, për periudhën kohore 18.04.2017 deri me 02.07.2021 ka realizuar 354 ditë të pranisë në punë, gjithsej në të dyja shkollat 622 ditë të prezencës në punë. Po ashtu, gjykata me të drejtë ka konstatuar se e paditura nuk i ka ofruar paditësit ushqimin gjatë punës përmes restorantit, kuzhinës apo në ndonjë formë tjetër. Për më tepër, sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, çmimi i biletës për relacionin Gjilan – Livoç i Epërm është vërtetuar përmes konfirmimit të Shoqatës për Transport të Udhëtarëve “Anamorava”. Rrjedhimisht, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar saktë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike.

Duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë të drejtën materiale e ka zbatuar në mënyrë të drejtë, pasi që në bazë të nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se *“...Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punon i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Sipas paragrafit 7 të të njëjtit nen është paraparë së *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Ndërsa në bazë të nenit 35 paragrafi 8, pika 8.1 të kësaj kontrate, është paraparë së *“Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë”*. Në mënyrë të njëjtë këtë çështje e ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, e cila me nenin 35 par.5, 7 dhe 8.1 ka rregulluar të

drejtën e punëtorëve të arsimit në kompensimin e pagave jubilarë, shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit gjatë punës. Prandaj, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe ka detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të pagës jubilarë për 10 vite përvojë të punës, shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e pranisë në punë t’ia paguaj paditësit shumat si në dispozitivin e aktgjyqimit të atakuar.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se kërkesa e paditësit përfshin ditë të llogaritura pas skadimit të afatit të Kontratës Kolektive, Gjykata e Apelit, vlerëson së ky pretendim nuk qëndron, pasi që Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, e lidhur dhe nënshkruar nga SBASHK-ut dhe MASHT, ka qenë në fuqi nga datë 18.04.2017, deri me datë 21.01.2021, sepse asnjëra palë nënshkruese nuk është tërhequr nga kontrata siç ishte përcaktuar me nenin 45 të KKAK-së. Gjykata e Apelit lidhur me kërkesëpadinë e paditësve e cila i përket periudhës pas datë 21.01.2021, vlerëson së e njëjta ka bazë në Kontratën Kolektive të Arsimit e Kosovës, Nr.prot.105, të datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, e cila me nenin 35 par.5, 7 dhe 8.1 ka rregulluar në mënyrë të njëjtë të drejtën e punëtorëve të arsimit në kompensimin e pagave jubilarë, shpenzimeve të ushqimit gjatë punës dhe udhëtimit.

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditësit pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes”*. Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë se: *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*. Duke qenë së e paditura në këtë rast është punëdhënëse e paditësit, Gjykata e Apelit vlerëson së e njëjta ka për obligim që t’ia bëjë kompensimin e shpërblimit jubilar, dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e pranisë në punë, ndërsa koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave, që buron nga Kontrata Kolektive, është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditësit dhe detyrimin e të paditurës.

Lidhur me pretendimin së kërkesa e paditësit është vjetërsuar bazuar në nenin 78 par.1 të Ligjit të Punës, pasi që paditësi nuk i ka shterur mjetet e brendshme para se të dorëzohet padia në gjykatë, Gjykata e Apelit gjeti së ky pretendim nuk qëndron, pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se paditësi i është drejtuar të paditurës me kërkesën e datës 19.12.2019 me të cilën ka kërkuar nga e paditura kompensimin shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit për ditët e pranisë në punë, e pastaj ka ushtruar padi në gjykatë. Për me tepër, kjo gjykatë vlerëson së e paditura ka pasur për obligim që paditësit t’ia paguaj kompensimin për ditët e pranisë në punë pa pasur nevojë që paditësi t’i drejtohet me kërkesë, sepse në rastet kur kemi

të bëjë me kërkesat në para, siç është rasti konkret, mos parashtrimi i kërkesës tek punëdhënësi nuk paraqet pengesë që i punësuar, në këtë rast paditësi, për realizimin e të drejtës së tij t'i drejtohet gjykatës me padi. Ndërsa në rastin konkret kërkesa e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim, për faktin së paditësi me datën 21.02.2020, ka paraqitur padi përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e pagës jubilarë, kompensimin e ushqimit dhe të udhëtimit, për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datën 16.04.2021, nga çka rezulton se nga fillimi i periudhën për të cilën kërkohet kompensimi e deri te paraqitja e padisë nuk kanë kaluar më shumë se tri vite, në mënyrë që të konsiderohet së kërkesa e paditësit është parashkruar ashtu siç përcaktohet me nenin 87 të Ligjit të Punës.

Vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së, e po ashtu edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1313/2022, më datë 26.09.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Hysni Bardheci